

L I G J
Nr.7797, datë 23.2.1994

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7678, DATË 3.3.1993 “PËR AKCIZATNË
REPUBLIKEN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Neni 3 i ligjit nr.7678, datë 3.3.1993 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshohet si vijon :

“Mallrat e veçanta që tatohen me akciza dhe përqindjet e tyre janë:

a) Duhan e prodhime duhaniPërqindja e akcizës

- Cigare	50
- Puro	70
- Duhan për konsum	70
- Letër cigareje për shitje	50

b) Pije alkoolike :

- Birrë	40
- Verë	40
- Raki	70

- Konjak, uzo, fërnjet, ponç, uiski,
rum dhe të gjitha pijet e tjera alkoolike 80

- Likernat 60

c) Pije të buta dhe freskuese 30

ç) Ujë mineral dhe i gazuar 20

d) Energji elektrike 50

dh) Alkool importi për shitje 50

e) Alkool prodhim vendi për shitje 30

Nuk zbatohet akcizë për alkoolin e prodhuar në vend dhe që përdoret për prodhimin e pijeve alkoolike.

ë) Kafe 30

f) Nënproduktet e naftës:

- Benzinë 45-89.9 oktan	60
- Benzinë 90 oktan e lart	50
- Gazoi	140
- Vajguri	40
- Valvolinë	80

- Vajra lubrifikante të të gjitha llojeve
dhe grasot80

- Të tjera (solar, mazut, koks nafte, bitum,
gaz i lëngët, toluol, squfur, ksilol,
solvent)25

Me përjashtim të vajgurit, energjisë elektrike dhe gazit të lëngët që i shitet popullsisë.

Për letrën e cigares, të importuar nga subjektet e ndryshme ekonomike dhe që duhet për nevojat e prodhimit, të mos zbatohet akcizë në doganë.

Merret në formë akcize edhe diferenca ndërmjet çmimit përfundimtar të shitjes dhe çmimit të caktuar nga organet shtetërore, duke i shtuar këtij të fundit për energjinë elektrike 50 për qind dhe për

nënproduktet e naftës përqindjet e caktuara në shkronjën “f” të këtij neni.

Për mallrat e përcaktuara në shkronjën “a”, kur importohen zbatohet një akcizë plus 35 për qind nga ajo e caktuar më lart, përjashtuar cigaret për të cilat zbatohet një akcizë plus 50 për qind, dhe për ato të pikës “b” plus 25 për qind.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

Shpallur me dekretin nr.792, datë 7.3.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.